	<p>gjithë kohëzgjatjen e projektit. Pjesëtarët e stafit, rroga e secilit prej tyre do të jetë e shënuar në kontratë, do të kenë si detyrë koordinimin e një profili specifik të projektit: administrativ/sekretarial; drejtues/operativ (në referim me aktivitetet dhe nënaktivitetet e shënuara në kontratë; ndërmjetësim gjuhësor (shqiptar). Në seminarin operative do të realizohet “check” rreth zhvillimit të projektit. Pikë-antena parashikon mobilimin e një strukture të asistencës informative rreth projektit për t’u vendosur pranë zyrës së Rajonit të Puglia-s në Pallatin e Kulturës në Tiranë. Projektet ekzekutive, që do të përpunohen nën kujdesin e një konsulenti ekspert të zgjedhur nga drejtuesi i Partnerit Leader (PPL) në fillim të projektit, i përkasin përshkrimeve të hollësishme dhe ekzekutive të aktiviteteve kryesore, të cilat do të ripërshtaten gjatë ecurisë së projektit. Shpenzimet e përgjithshme përbëhen nga shpenzimet e lejuara nga Vademecum (shpenzimet telefonike, telematike, postale, kancelerie, siguracione, etj). Shpenzimet për përkthimet dygjuhësore të buletinëve si dhe të testeve të ndryshme; mediatorët gjuhësorë do të zgjidhen nga drejtuesi i Partnerit Leader kryesisht ndër ekspertët shqiptarë. Shpenzimet e paparashikuara do të jenë për nevojat e lindura të cilat nuk janë përfshirë në asnjë aktivitet të projektit. Disa nga aktivitetet e përshkruara çojnë në organizimin dhe realizimin e udhetimeve dhe transfertave për pjesëmarrjen e partnerëve në aksione të ndryshme në Itali e në Shqipëri: kostoja e çdo transferte –tip (me 1 prenotim) është 470 euro maksimumi, ku 250 euro maksimumi për ushqim/fjetje në hotel /dietë e 220 euro maksimumi për udhëtimin vajtjeardhje; në rastin e transfertave me më shumë se një prenotim kostoja rritet proporcionalisht. Nevojat administrative në lidhje me udhëtimet e transfertat do të zgjidhen nga PPL për të gjithë partnerët e projektit, për arsye efëçence, koordinimi e thjeshtësimi organizativ. PPL i është besuar administrimi i të ashtuquajtura “shërbime në Shqipëri”, do të thotë blerja e produkteve e shërbimeve drejtëpërdrejtë në Shqipëri, që do të lejojë kompensimin e partnerëve shqiptarë pjesëmarrës në konsulencë e shërbime, realizimin e printimeve dhe/ose shumëfishimeve të buletinëve dygjuhësh të besuar partnerëve, të produkteve të tjera ilustrative, parashikimin e shpenzimeve të ndryshme të transportit, shpërndarjes, hosting, përkthimit, huazimit, catering, etj.</p>	
8	<p>Aktiviteti i përket vlerësimit të kartave të arkivit egzistues në Shqipëri e në Itali me interes të përbashkët italo-shqiptar. Aktiviteti do të zhvillohet nga viti 2005 deri në vitin 2007, me pjesëmarrjen përveç Ninive e Iride edhe të katër partnerëve të tjerë: IPSAIC, Fondacioni Gramsci di Puglia, Federata pugliese e AICCRE, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë. PPL do të impenjojë në vlerësimin e kartave të arkivit të seleksionuara 2 pjesëtarë të stafit me profesion arkivues-dokumentalist. Objektivi strategjik i këtij aktiviteti është njohja më e mirë dhe vlerësimi i bazat e përbashkëta të identitetit mesdhetar, komponent thelbësor e krijues i një identiteti të përbashkët evropian i cili do të realizohet në planin institucional me urimin e hyrjes së republikës së Shqipërisë në B.E.. Në veçanti, partneri shqiptar do të bashkëpunojë me partnerët italianë referues për seleksionimin e vlerësimit (studim, klasifikim, inserimin on line) të kartave që i përkasin Puglia-s e në ëpërgjithësi marrëdhënieve italo-shqiptare moderne e kontemporane egzistuese pranë Arkivit Qëndror të Republikës së Shqipërisë në Tiranë. Kujdes do t’i kushtohet kartave të arkivit që i përkasin periudhës pas Pavarësisë më 1912, periudhës së pushtimit italian, çështjes së hebrenjve në vitet ’30 e ’40 (me qëndrimin pozitiv të Autoriteteve shqiptare, të Luogotenenza së përgjithshme e të Komandove ushtarake italiane), periudhën e Luftës Çlirimtare. Partneri shqiptar do të realizojë një “fond Italia” për ta vendosur në një sallë të</p>	

	<p>Arkivit Qëndror në Tiranë, ku do të grumbullohen në origjinal ose kopje (edhe me ndihmën e mikrofilmave), kartat të vlerësuara si më interesantet. Për aksionet, partneri shqiptar do të ndihmohet nga 5 të rinj kërkues dhe/ose arkivues për t'u impenjuar me kontrata në bazë të indikacioneve të partnerit shqiptar. Ndërsa partneri AICCRE do të realizojë informimin, trajnimin dhe axhornimin si të kërkuesve (italianë e shqiptarë) të impenjuar në studimin e arkivave me interes të përbashkët italo-shqiptar, ashtu edhe të mësuesve të shkollave mesme shqiptare, nëpërmjet kurse leksionesh, seminareve, konferencave, laboratorëve o workshop-ve rreth historisë, të drejtës, normativës, ekonomisë, tregëtisë, problematikave aktuale të B.E. e të marrëdhënieve ndërkombëtare, me interes të veçantë për tematikat e Vendeve të Mesdheut e të zonës ballkanike. Seksionet e informacionit, trajnimit e axhornimit rreth B.E. e rreth të drejtës nderkombetare për t'u zhvilluar në Itali ashtu edhe në Shqipëri (në rastin e fundit në lidhje me mësuesit shqiptarë). Partnerët italianë IPSAIC e Fondacioni Gramsci do të bashkëpunojnë për realizimin e aksioneve të ndryshme me rëndësi absolute: trajnimi dhe axhornimi i kërkuesve italianë e shqiptarë si dhe të mësuesve të shkollave të mesme shqiptare në lidhje me marrëdhëniet historike midis Shqipërisë e Italisë dhe në veçanti Puglias; sistemimin, klasifikimin, studimin e publikimin e një seleksioni të kartave të arkivit në lidhje me marrëdhëniet midis Italisë e në veçanti Puglia-s e Shqipërisë të ruajtura pranë Arkivit Qëndror Shqiptar në Tiranë e të disa arkivave italianë (Instituti historik i Rezistencës, ANPI, Arkivat e Shtetit), duke përcaktuar një ose më shumë tematika me interes të veçantë, të pabotuara ose pak të njohura me interes të veçantë për çështjet në lidhje me Luftën çlirimtare dhe me ushtarakët italianë pas 8 Shtatorit 1943; realizimin e një “fondi Shqipëria” në Puglia edhe nëpërmjet kopje/shkëmbim/mikrofilma të materialeve të Arkivit Qëndror Shqiptar; realizimin e një “Qendre dokumentimi hebre” që grumbullon në origjinal ose në kopje kartat në lidhje me komunitetin hebre shqiptar e marrëdhëniet e tij me Puglia-n, sidomos gjatë çështjes së Olokaustit. Do të realizohet edhe një mostër dokumentare.</p>	
--	---	--

3.3.2 Kosto e aktiviteteve për çdo partner

3.3.3. Kostot e aktivitetit n° 8 (Vlerësim i kartave të arkivit me interes të përbashkët italo-shqiptar)

ZERI I SHPENZIMEVE	SHUMA
Shërbime Studiues, Kerkues arkivues, profesorë të zgjedhur nga partners Fondacioni Gramsci, IPSAIC, AICCRE	52.000,00
Personeli Të rinj arkivuesë/dokumentalistë/kërkues shqiptarë të zgjedhur nga partner Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë	24.000,00
Shpenzime të përgjithshme	12.000,00
Transferta	16.000,00
Komunikim e informacion Mostra rreth kartave më të rëndësishme të arkivit	5.000,00
Shërbime në Shqipëri Occorrenze të ndryshme për vlerësimin e kartave të arkivit të depozituara në Shqipëri	20.000,00
Shpenzime të tjera Publikim i tre katalogëve (karta të vlerësuara të “fondit Shqipëri”, e “fondit Itali” e të Qendrës së dokumentacionit hebre	18.000,00
Koordinim i projektit N° 2 unita të stafit të koordinimit të projektit me profesionalitet arkivistiko-dokumentalist për t’u impenjuar në vlerësimin e kartave të arkivit të pranishëm në Itali e për rakordinimin me aksionet në Shqipëri, përveç nevojave për kontabilitet/administrim e mediacion gjuhësor	77.000,00
TOTALI	224.000,00

Kini parasysh. Shuma e zërave të shpenzimeve i referohen viteve 2006-2007.

3.4 Treguesit e realizimit

Aktiviteti	Treguesi	Njësia matëse	Sasia e parashikuar		
			Itali	Shqipëri	Totali
1	PC notebook i pajisur me printer për zyrën InfoPoint Europa	N°	==	3	3
1	Zyra Infopoint Europa	N°	==	3	3
1	Kit satelitor për Zyrën InfoPoint Europa	N°	==	2	2
1	Software interaktiv për zyrën Infopoint Europa	N°	==	3	3
1	Lidhje telematike ADSL për Zyrën Infopoint Europa	N°	==	1	1
1	I ri ekspert (impianti Infopoint)	N°	2	1	3
1	I ri bashkëpunëtor (Zyrat Infopoint Europa në funksion)	N°	==	6	6
8	I ri ekspert (arkivat shqiptarë)	N°	==	5	5
2	Çmimi Best-Practice	N°	==	3	3
3	Buletinë dygjuhësh: n° 30 numra të artikuluar në 5 buletinë(*)	N°	14	16	30
3	Cikle diskutimi rreth përmbajtjes së buletinëve	N°	3	3	6
3	I ri bashkëpunëtor (Buletinë dygjuhësh të palës shqiptare)	N°	==	10	10
4	Konferencë-shtypi	N°	2	2	4
7	Meeting rreth projektit	N°	==	3	3
4	Seksioni Web	N°	1		1
7	Seminar operativ	N°	2	2	4
5	Workshop rreth NPM	N°	2	2	4
5	Repertor bibliografik on line	N°	1	==	1
5	Volum dygjuhësh i akteve rreth NPM	N°	1	==	1
7	Pikë-antena informative	N°	==	1	1
7	I ri bashkëpunëtor (staf i projektit)	N°	4	1	5
5	Dokumentar VHS dygjuhësh prototip	N°	3	3	6
5	Dokumentar DVDROM dygjuhësh prototip	N°	3	3	6
5	Brochure me skeda rreth projektit	N°	1	==	1
5	Totem statik	N°	2	6	8
5	Observator rreth praktikave pozitive	N°	==	1	1
5	Raport rreth praktikave pozitive	N°	==	3	3
8	Fondi i arkivit "Itali"	N°	==	1	1
8	Fondi i arkivit "Shqipëri"	N°	1	==	1
8	Qendra e dokumentacionit hebre	N°	1	==	1
8	Repertor arkivues on line	N°	1	==	1
8	Kurs trajnimi e axhornimi	N°	n	n	N
8	Publikime	N°	2	1	3
6	Raport i rendikontit të projektit	N°	4	==	4

(*)**Partneri Nivine:** Pranë Teca del Mediterraneo: 1 buletin monotematik x 1 fashikull në vitin e parë; x 3 fashikuj në vitin e dytë, x 3 fashikuj në vitin e tretë. Pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë: 1 buletin monotematik x 2 fashikuj në vitin e dytë, x 2 fashikuj në vitin e tretë. Pranë Bibliotekës së Elbasanit: 1 buletin monotematik x 3 fashikuj në vitin e dytë, x 3 fashikuj në vitin e tretë.

Partneri Iride: Pranë Teca del Mediterraneo: 1 buletin monotematik x 1 fashikull në vitin e parë; x 3 fashikuj në vitin e dytë, x 3 fashikuj në vitin e tretë. Pranë Bibliotekës së Shkodrës: 1 buletin monotematik x 3 fashikuj në vitin e dytë, x 3 fashikuj në vitin e tretë

Situatat e projektit

Situata fillestare:

Situata fillestare e Bibliotekave shqiptare dhe e Qendrave të dokumentimit evidenton pika kritike si në terma të

burimeve teknologjike info-telematike ashtu dhe në aplikime të vlerave të drejtimit modern. Kjo situatë rëndohet më shumë nga vështirësitë financiare të strukturave, që nuk lejojnë institucionet kulturore të parapërgatitin një plan organik të ndërhyrjeve teknike e formuese, i domosdoshëm ky për eliminimin e këtij ndryshimi të madh. Në Shqipëri me ligjin nr. 8576 të 2000 është bërë shumë për të vendosur bazat normative të krijimit të një sistemi bibliotekor kombëtar të integruar e të specializuar.

Gjithashtu, edhe sipas relatorëve shqiptar gjatë seminarit të mbajtur në Bari më 12 Tetor 2001, rruza më e shpejtë dhe më efektive për të përmirësuar situatën është përfshirja direkte e bibliotekave publike nëpërmjet koordinimit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Përsa i përket Arkivit Qëndror të Shqipërisë, egzistenca në të e korrespondencës së marrëdhënieve Itali e Puglia – Shqipëri, sidomos në periudhën pas vitit 1912, shumica e tyre të pabotuara ose të njohura shumë pak, bën të nevojshëm realizimin e një aksioni veprimi për vlerësimin e këtij dokumentacioni, si dhe për sensibilizimin e shoqërisë albaneze e pugliese rreth përmbajtjeve të këtyre kartave. Problematikat për t'u përballuar duhen konsideruar edhe në lidhje me vështirësitë që Shqipëria po kalon në terma ekonomik, social e fatkeqësisht edhe kulturor. Prandaj Bashkimi Europian duke ndërhyrë në fushën e “knowledge” mund të bëjë shumë për të ndihmuar Shqipërinë të dalë nga kjo situatë e vështirë.

Novacionet e parashikuara:

Këto novacione janë për t'u raportuar:

- a)- në procesin e përcaktimit të tematikave tejkufitare e ndërkulturore të kryera nga strukturat e përfshira në projekt , nëpërmjet realizimit të buletinëve dygjuhësh periodik;
- b)- në instalimin e strukturave dhe në përdorimin e metodave operative që kanë si qëllim, veç të tjerash, promovimin e të drejtës për marrjen e informacionit europian në të mirë të të gjithë qytetarëve;
- c)- në vendosjen e qartë, nëpërmjet ballafaqimeve dypalëshe, të modeleve drejtuese menaxheriale të bazuara – sipas normave të “New Public Management” – rreth ndërlidhjes sistematike të aktiviteteve organizative (planifikim, programim, trajnim të personelit), të drejtimit (edhe sipas normave të “outsourcing”) e të monitorimit (autokontrolli para, gjatë e pas projektit).

Përfitimet direkte në lidhje me realizimin e projektit:

Këto përfitime janë për t'u përcaktuar :

- a)- nga mundësitë që do t'i krijohen popullsisë, që frekuenton Bibliotekat ose Arkivat pjesëmarrëse në projekt, për shfrytëzimin me sukses të informacionit tematik e dygjuhësh, e vlefshme kjo edhe për lehtësimin e përdorimit të fondeve biblio-dokumentare e arkivuese të mbledhura;
- b)- nga shanset e reja të ofruara përdoruesve nga një qarkullim më i rregullt e më i detajshëm i informacioneve rreth normave, drejtimit, lehtësimeve financiare e projekteve të aprovuara nga Bashkimi Europian;
- c)- nga mundësia për subjektet me përgjegjësi drejtuese për t'u vlerësuar me çmim për impenjimin e tyre personal dhe për aftësitë e tyre novative në aktivitete profesionale;
- d)- nga mundësia e strukturave pjesëmarrëse për të moderuar teknologjitë e veta, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve teknologjike të siguruara nga projekti (kompiuter, software, etj.).

Përfitimet jo të drejtëpërdrejta lidhur me realizimin e projektit:

Projekti synon të krijojë përfitime jo të drejtëpërdrejta sidomos në kuadrin e përdorimit të burimeve njerëzore sidomos të të rinjve, të një qarkullimi më të madh të informacionit, të një njohje më të mirë të Bashkimit Europian e të një pjesëmarrje më të gjerë të të dy popujve kufitar në rritjen e tyre në aspektin ndërkulturor. Në veçanti, përfitimet e angazhimit me punë do të jenë të mundur nëse do të verifikohen të paktën dy kushte: e para i referohet konsolidimit të veprimeve të kryera në strukturat shqiptare të përfshira në projekt; e dyta i referohet parashikimit të një aktiviteti të përgatitjes teknike e profesionale të të rinjve, të aftë në përdorimin e pajisjeve informatike.

3.5.1 Studime dhe/ose projekte të njohura të mundshme

Nuk ka asnjë të dhënë për studime ose projekte në të kaluarën rreth bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave të përfshira në

këtë projekt. Mund të përmendet vetëm një Urdhër i Ditës miratuar në Bari në Tetor 2001 gjatë seminarit ndërmjet strukturave bibliotekore shqiptare dhe “Teca del Mediterraneo”, që flote palët institucionale (bibliotekat e qendrat e dokumentimit italiane e shqiptare) të intensifikonin marrëdhëniet kulturore për përhapjen e kulturës europiane e për një njohje më të gjerë të të dyja kulturave.

3.6 Lokalizimi i projektit

Itali Bari	Biblioteka Multimediale e Këshillit Rajonal të Puglia-s “Teca del Mediterraneo” dhe struktura të tjera partenariale
Shqipëri Tiranë Tiranë Tiranë Elbasan Shkodër	Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë Biblioteka e Akademisë së Shkencave së Shqipërisë Arkivi Qëndror i Shtetit Biblioteka publike “Qemal Baholli” Biblioteka publike “Marin Barleti”

3.7 Periudha e realizimit të projektit

Data e parashikuar për fillimin e projektit	01-01-2004
Data e parashikuar për përfundimin e projektit	31-12-2007
Totali i muajve	48

3.8 Kronograma e aktiviteteve: diagrama GRANNT

N° Aktiviteteve	Viti 1 (2004)												Viti 2 (2005)											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1 InfoPoint Europa									X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
2 Çmimi									X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
3 Buletinët									X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
4 Komunikimi					X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
5 NPM						X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
6 Monitorimi Rendikonti	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
7 Top Management	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
8 Kartat e Arkivit																							X	X

Kronograma e aktiviteteve: diagrama GRANNT (vazhdim)

N° Aktiviteteve	Anno 3 (2006)												Anno 4 (2007)											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Plotësues i Projektit;

3. përcaktohen qartë “ab initio” si subjekte partnerë të projektit ashtu dhe Leader i projektit;
4. ndërhyrja e propozuar në tre zonat e miratuara nga PIC në veçanti Puglia (Bari) për Italinë dhe për Shqipërinë Bibliotekat e Elbasanit, Shkodrës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Biblioteka e Akademisë së Shkencave dhe Arkivi Qëndror i Shtetit në Tiranë.

Projekti, gjatë gjithë artikullimit të tij, në brendësi të PIC Interreg III, është i mirëkoordinuar me aksin dhe me mizurën e referimit.

Ky projekt synon promovimin dhe çuarjen më tej të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve bibliotekore, qendrave të dokumentimit e arkivave për zhvillimin dhe përhapjen e novacioneve në modelet e organizimit, drejtimit e monitorimit të pasurisë kulturore nëpërmjet mbrojtjes dhe vlerësimit të tyre.

Mizura në të vërtetë tenton të mbështesë mënyrat e reja të bashkëpunimit ndërmjet subjekteve të të dyja palëve në fushën e mbrojtjes, promovimit dhe vlerësimit të pasurisë kulturore, historike e arkeologjike me interes të përbashkët.

Instrumenti për realizimin e këtyre objektivave është forcimi i shkëmbimeve ndërkulturore ndërmjet zonave të interesuara për Programin.

Pra bëhet fjalë për veprime integruese për vlerësimin dhe përdorimin e qarqeve kulturore në kuptimin më të plotë të tyre: nga pasuritë arkeologjike deri tek ato historike-kulturore me interes të përbashkët; nga kulturat tradicionale e moderne tek novacionet teknologjike e organizative ndërmjet strukturave publike për konservimin dhe vlerësimin e pasurive arshivuese e dokumentale me rëndësi historiko-kulturore.

Projekti vlerëson konceptet e bashkëpunimit e të partneritetit ndërkombëtar që nga momenti i shqyrtimit të njohurive e teknikave të partnerëve të ndryshëm, pjesëmarrës në projekt.

Koncepti i novacionit është një tjetër aspekt shumë prezent në projekt në kuptimin që favorizohet përdorimi i teknologjive të reja informatike, si dhe praktika menaxheriale të drejtimit të strukturave, krijimi i organizmave të front-office që do të realizojnë një koncept modern e të ri të informacionit, përpunimi i instrumentave bibliekonomikë të avancuar si p.sh. buletinët tematikë.

Prania e Info-Point Europa garanton një formë zhvillimi kulturor me përplasje të dukshme si në nivel njohjeje ashtu dhe angazhimi me punë. Publikimi i buletinëve tematikë do të garantojë një fushë të interesave të përbashkët në ndihmë të konceptit të ndarjes me të tjerët të tematikave, të problemeve, të objektivave dhe të procedurave të punës.

3.10	Integrimi dhe plotësueshmëria me mizurat e tjera të Programit
	<p>Projekti integrohet më së miri me objektivat e tjerë specifik të Aksit IV dhe është plotësues me mizurat e tjera të Programit (mbrojtja dhe promovimi i pasurisë historike e kulturore, konsolidimi i shkëmbimeve kulturore, fuqizimi e integrimi i shërbimeve turistike, promovimi i burimeve turistike).</p> <p><u>Mizura 4.2</u> : “Mbështetje e partenariatit Italo-Shqiptar në turizëm” që synon mbështetjen e aktiviteteve turistike-pritëse që të jenë të integruara me iniciativat e vlerësimit të qarqeve kulturore (të përcaktuara si në mizurën 4.1). Ka si objektiv specifik fuqizimin dhe integrimin e shërbimeve turistike, promovimin e burimeve turistike, zhvillimin e formave të turizmit alternativ;</p> <p><u>Mizura 4.3</u> : “Zhvillimi i bashkëpunimit institucional e kulturor” që synon forcimin e lidhjeve institucionale e kulturore midis të dy palëve dhe vlerësimin e identitetit</p>

historiko -kulturore të realiteteve të ndryshme rajonale. Ka si objektiva specifike fuqizimin e bashkëpunimit institucional e kulturor në fushat me interes të përbashkët në organizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike të një rëndësie të veçantë sociale për cilësinë e jetës.

Objektivat e përbashkëta me mizurat e sipërpërmendura të Programit, garantojnë me qëllim zhvillimin e njohurive shkencore të ngjarjeve historike, kulturore, artistike e sociale në zonën e Ballkanit nëpërmjet mbledhjes, koordinimit, promovimit, publikimit dhe shpërndarjes së dokumentacioneve, të cilat promovojnë dhe rivlerësojnë imazhin e Shqipërisë.

Analiza dhe studimi i tematikave kulturore, të cilat kanë të bëjnë me format e ndryshme të njohurive, janë monitoruar në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet realizimit të takimeve, mbledhjeve e seminarëve si dhe të publikimit të studimeve, kërkimeve e akteve që kanë të bëjnë me aktivitetet e lartpërmendura me anën e përkthimeve të dokumentave.

Kështu që, prania e Bibliotekave, të Qëndrave të dokumentimit e të Arkivave, është e një rëndësie të veçantë në rolin e ballafaqimit si dhe të një pike referimi ndërmjet realiteteve të shpërndara në territorin e marrë në konsideratë (shoqatat kulturore, shkollat, Universitetet etj.).

3.11 Vazhdimësi me projektet Interreg të realizuara gjatë periudhës së mëparshme të programimit

X Si No

3.12	Nëse po, specifiko:
	<p>Projekti paraqet vazhdimësi me mizurën 7.1 të PIC Interreg IIIA Itali-Shqipëri, që ka të bëjë me asistencën teknike, monitorimin, vlerësimin e informimin, aspekti financiar i të cilit është zbatuar me vendimin nr.1648 të 1999 të Giunta Regionale (Këshilli Krahinor); ky vendim ka parashikuar realizimin e një ekspozite pranë Bibliotekës së Këshillit Rajonal, krijimin e një siti web dhe realizimin e dy seminareve mbi temat e një drejtimi bashkëlidhës të bibliotekave të komuniteteve lokale gjatë “Korridorit 8”.</p> <p>Seminari përfundimtar, i koordinuar nga Biblioteka e Këshillit Rajonal, i la vendin Urdhërit të Ditës që paraqet pikënisjen e këtij projekti.</p>

3.13	Plotësueshmëria e projektit me Programin CARDS dhe me programe të tjera bashkëpunimi.
	<p>Paraprkisht vlen të kujtohet se Interreg III është një Program i Iniciativës Komunitare (PIC) që promovon forma të bashkëpunimit tejkufitar, ndërkombëtar e ndërrejonale për të favorizuar zhvillimin e ekuilibruar të zonave shumërejonale.</p> <p>Në 1999 Italia i propozoi Komisionit European njohjen e gjithë kufirit përgjatë Adriatikut për të marrë pjesë në Interreg III pra domethënë përfshirjen e të gjitha provincave bregdetare italiane e të Ballkanit Perëndimor në Programin Interreg III të bashkëpunimit</p>

tejkufitar.

Propozimi nuk u pranua por Komisioni European, duke verifikuar kushtet e jetesës në zonat e lartëpërmendura, të vëna në dukje nga ana e Italisë, miratoi Programin CARDS në të cilin parashikohet një koordinim me Interreg III me qëllim favorizimin e “bashkëpunimit tejadriatik”. Ky koordinim ka bërë të mundur miratimin e PIC Interreg III A Itali-Vendet Lindore të Adriatikut (Transadriatico), të cilin Rajoni i Puglia-s e ka njohur zyrtarisht me vendimin e Këshillit Rajonal nr.734 të 2003.

Programi CARDS është një “program asistence, rikontruksioni, zhvillimi e stabilizimi relativ ndaj asistencës për Shqipërinë...” integrohet më së miri me Interreg III dhe me projektin në fjalë, që si shprehës i Programit Interreg është plotësues me Programin CARDS.

CARDS vendos një mbështetje strategjike në asistencën e dhënë Vendeve SAP (Vende në Proces Stabilizimi dhe Asocimi) : ndërsa çdo Vend bën progres në Procesin e Stabilizim Asocimit, asistenca brenda një kuadri strategjik 2000-2006, ofrohet me ndërmjetësinë e një programi trevjeçar e njëvjeçar që lejon nisjen e asistencës komunitare në një perspektivë afatmesme duke e koordinuar me ndihmat e ofruara nga Shtetet anëtare.

3.14	Integrazione e complementarietà del progetto con altri programmi anche comunitari e con le politiche nazionali e regionali
	<p>Me Interreg II janë zhvilluar forma të nevojshme bashkëpunimi ndërmjet Italisë e Shqipërisë e sidomos në gjirin gjeografik Jon –Adriatiku jugor; këto kanë bërë të dalë në dukje një realitet social-gjeografik (një zonë) brenda së cilit komunitetet përjetojnë gjithnjë e më shumë mundësi pune e jete të përbashkëta e, për më tepër po përhapen shumë interesat ekonomike, kulturore, social-politike për të cilat është e nevojshme një vëmendje e veçantë edhe në lidhje me kriterin e koordinimit të Interreg-ut e të instrumentave të tjerë të politikës së jashtme të Bashkimit European.</p> <p>Këto raporte bashkëpunimi ndërmjet popujve duhen inkurajuar sepse mund të ndihmojnë për krijimin e kushteve të nevojshme për t’i bërë popujt të ndihen pjesëtarë të familjes së madhe europiane.</p> <p>Për të favorizuar zhvillimin e një bashkëpunimi efektiv është e nevojshme të krijohen kushtet për një integrim të fortë ndërmjet Programit Interreg III, burimeve të Qeverisë Italiane të impenjuara në aktivitete të bashkëpunimit institucional me Shqipërinë, burimeve të vëna në dispozicion me të tjera Programe komunitare si për shembull Phare, TACIS, MEDA, ISPA, FES, CARDS e të tjerë.</p> <p>Në mënyrë të tillë sigurohet një integrim e plotësueshmëri e lartë ndërmjet ndërhyrjeve të programuara.</p> <p>Rajoni i Puglia-s, si Rajon kufitar që në të vërtetë ka zhvilluar një bashkëpunim të fortë me Shqipërinë (p.sh. Fiera del Levante që prej disa vitesh zhvillohet edhe në Tiranë) -edhe pse ka akoma shumë për t’u bërë- është thirrur për t’i dhënë një kontribut domethënës procesit të integritit dhe zhvillimit të bashkëpunimit.</p> <p>Në një logjikë integrimi e plotësueshmërie komplekse nuk mund të mos përmendësh problemet e të rinjve dhe mundësitë e angazhimit me punë edhe në formë autonome, për këtë është e nevojshme që komunitetet lokale dhe administratat publike të përpiqen për një bashkëpunim më efikas dhe për një informim konstant.</p> <p>Në kuadrin e “korridorit 8” gjejnë hapsirë edhe projekte të tjerë specifike.</p> <p>Duket qartë që në këtë këndvështrim projekti ndihmon në realizimin e politikave komunitare, kombëtare e rajonale duke u mbështetur qartë në ligjin rajonal nr. 20/2003.</p>

4. Aspektet tejkufitare

4.1	Përshkrimi i karakteristikave tejkufitare të projektit dhe rezultatet e pritshme
	<p>Është përmendur në rezultatet e pritshme tejkufitare edhe në terma të objektivave të projektit dhe në terma të përfitimit.</p> <p>Në këtë pjesë të projektit është me vend të nënvijëzohet fakti që popujt kufitarë me kohë kanë nisur raporte bashkëpunimi në terma ekonomikë (tregtarë, turistikë, etj.) dhe institucionet lokale janë përpjekur për të bashkëpunuar në terma kulturorë.</p> <p>Bëhet fjalë që me Interreg III e me të tjerë Programe të bashkëpunimit, të riorganizohen, të inkurajohen e të mbështeten mundësitë e shumta të shkëmbimeve dhe të ndërtohen interesa të reja të përbashkëta në mënyrë të programuar dhe të përgatiten veprime, projekte e programe të integruara për një organikë të zhvilluar të të dy Rajoneve.</p> <p>Rezultatet tejkufitare të pritura, konsistojnë në forcimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit tejkufitar.</p> <p>Më të konkretizuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) në formalizimin e partenariatit midis Bibliotekës së Këshillit Rajonal të Puglia-s, Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Bibliotekës së Akademisë së Shkencave Tiranë, Bibliotekave Publike të Shkodrës e Elbasanit dhe Drejtorisë Qëndrore të Arkivave të Shqipërisë; b) në kryerjen e seminareve e workshop në të dy Vendet për të krahasuar praktikat, rezultatet e arritura dhe për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme procedurat e reja; c) në fuqizimin e bashkëpunimit institucional, sipas kriterit të “institutional building”, midis komuniteteve lokale me qëllim shoqërimin e procesit të shkëmbimeve kulturore; d) në plotësimin me programin CARDS e me projektet e tjera të bashkëpunimit; e) në mundësinë që popujt të ndihen gjithnjë e më shumë qytetarë europian nëpërmjet njohjes e mirëkuptimit të diversiteteve respektive e në të njëjtën kohë, të elementëve të përbashkët që karakterizojnë dhe që bëjnë të mundur integrimin e tyre; f) në promovimin e njohjeve të pasurive biblio-dokumentare të quajtura si të mira kulturore për t’u tuteluar e për t’u vlerësuar në një këndvështrim ndërkulturor dhe të mbështetur nga dygjuhësi; g) në përmirësimin cilësor të ofrimit të shërbimeve publike, e si të tilla edhe shërbimet biblio-dokumentare.

4.2	Vlera e shtuar tejkufitare e projektit në nivelin social e ekonomik
	<p>Projekti tenton të racionalizojë e të fuqizojë bashkëpunimin ndërmjet Bibliotekave e Qëndrave të dokumentimit e Arkivat e komuniteteve lokale të të dy Rajoneve. Ai krijon vlerë të shtuar tejkufitare për sa më poshtë:</p> <p>a)- do të jetë kryesisht i realizuar në Shqipëri nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:</p> <p>a.1)- seminare operative rreth projektit dhe workshop rreth NPM;</p> <p>a.2)- botim të buletinëve dygjuhësh dhe “cikle diskutimi”;</p> <p>a.3)- çmimi “Best Practice”;</p> <p>a.4)- krijimi i zyrave Info Point Europa e i një pike-antene;</p> <p>a.5)- krijimi i një Observatori rreth best practices.</p> <p>b)- lejon promovimin e bashkëpunimit të të rinjve shqiptarë për përmirësimin e profesionalitetit të tyre në fushën info-dokumentare, e gjithashtu zhvillon:</p> <p>b.1)- mundësinë e dhënies së përgjigjeve konkrete njërit prej prioriteteve (aktivitete trajnimi në favor të nxitjes së punësimit) të parashikuara nga të gjithë Programet Operative miratuar nga B.E.;</p> <p>b.2)- promovon barazinë gjinore, në linjë me disa prej vendimeve më të rëndësishme të Këshillit Europian;</p> <p>c)- përdorë forma të avancuara të partneritetit ndërmjet pjesëtarëve të ndryshëm të Komuniteteve pjesëmarrëse;</p> <p>d)- promovon sinerji të rëndësishme ndërmjet strukturave publike e operatorëve privatë, si italian ashtu edhe shqiptar;</p> <p>e)- modernizon strukturat shqiptare të përfshira në projekt përsa i përket drejtimit, përmirësimit cilësor, duke pasuruar ofertën e shërbimeve publike me një vlerë të lartë të “Njohurive”.</p> <p>Projekti do të integrohet me të tjera iniciativa për vlerësimin dhe përdorimin e qarqeve kulturore: nga pasuritë arkeologjike tek ato historiko-kulturore me interes të përbashkët, nga kulturat tradicionale e moderne tek novacionet teknologjike e organizative ndërmjet strukturave publike për konservimin dhe vlerësimin e pasurive arshivuese e dokumentare të një rëndësie historike-kulturore me interes të përbashkët.</p> <p>Janë këto motivimet më të rëndësishme të projektit e që pa dyshim përbëjnë një vlerë të shtuar tejkufitare.</p> <p>Njohja reciproke e traditave, e historisë, e pasurisë kulturore, historike, arkitektonike, biblio-dokumentare do të forcojnë “shkrirjen” ndërmjet dy Rajoneve, me qëllim realizimin e një “zone të vetme” gjeografike.</p> <p>Në këtë drejtim Bashkimi Europian, me Programet e tij Operative, kërkon të lehtësojë një proces integrimi që popujt, në mënyrë të pavarur kanë nisur tashmë.</p>

4.3 Projekti parashikon aktivitete për t’u realizuar vetëm në Puglia?

Po Jo

4.4	Përshkrimi i detajuar, për ndikimin e rëndësishëm që ka projekti për palën shqiptare
	Projekti, ashtu siç është strukturuar, ka një ndikim të vecantë për palën shqiptare.

referuar drejtëpërdrejtë partnerëve shqiptarë përbëjnë 32.4% të shpenzimeve totale), prandaj një pjesë e rëndësishme e projektit do të përfshijë jo vetëm zbatuesit e detyrave por edhe popullsinë.

Mbështetja formale e projektit nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Biblioteka e Akademisë së Shkencave Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë dhe Bibliotekave Publike të Shkodrës e Elbasanit përbën një fillim serioz për t'u konsoliduar e për të institucionalizuar marrëdhëniet me Bibliotekën e Këshillit Rajonal të Puglia-s.

Kjo mundësi është shumë domethënëse e këshillon të gjitha sforcimet e mundshme derisa të nisë një proces ose një "protokoll" që parashikon në mënyrë sistematike konsultime për vazhdimin e institucionalizuar të bashkëpunimit aktual.

Informatizimi i strukturave publike shqiptare të lartpërmendura, lejon hyrjen jo vetëm në njohjen e pasurisë biblio-dokumentare por edhe në informacionet e ardhura nga Bashkimi Europian; kjo mundësi rrit qarkullimin e informacioneve dhe të mundësive të ofruara nga vet K.E.

Bashkëpunimi i parashikuar me qëllim vlerësimin tematik e dygjuhësor të pasurisë biblio-dokumentare i lejon Shqipërisë të bëjë të njohur prodhimin e vet letrar, kulturën, traditat: pra bënë të mundur njohjen e Shqipërisë e të nevojave reale të saj; nga ana tjetër shpërndarja e buletinëve tematikë dygjuhësh që do të realizohen nga Kooperativa Ninive e nga Shoqata Iride do të lejojë përdoruesit shqiptarë të njohin më mirë debatin dhe zhvillimin kulturor Italian.

Gjithashtu ballafaqimi i dy realiteteve rreth mënyrave të drejtimit të Bibliotekave, i ndihmuar edhe nga botimi i buletinëve nga ana e LTC, përbën vlerë të shtuar tejkufitare sepse favorizon homogjenitetin e drejtimit të strukturave të biblio-dokumentimit në planin e menaxhimit e të novacioneve konform standarteve europiane (New Public Management).

Projekti përmban elementë të tjerë shumë domethënës në termat e ndikimit në palën shqiptare: i referohemi mundësive të bashkëpunimit profesional të të rinjve në fushën e informacionit dhe të dokumentimit, aksione këto që objektivisht favorizojnë nxitjen e punësimit.

Ky është sigurisht një fakt i ri për Shqipërinë: mundësia e të rinjve të arsimuar për t'u futur në procesin e rritjes social-ekonomike të B.E. nëpërmjet qarkullimit të lirë të informacionit falë edhe përdorimit cilësisht të përmirësuar të Bibliotekave publike.

Projekti do të prodhojë efekte pozitive edhe për një periudhë afatmesme. Mundësia për të prezantuar në mënyrën e duhur Shqipërinë dhe shqiptarët, nga njëra anë do të lehtësojë hyrjen në Itali të punëtorëve shqiptarë e, nga ana tjetër do të ngjallë dëshirën e ndërmarrjeve italiane për të investuar në këtë territor, jo më e jo vetëm për arsyen e thjeshtë të përfitimit por edhe për arsye kulturore. Kuptohet që këtu luan një rol shumë të rëndësishëm edhe integrimi i plotë europian i Shqipërisë.

Gjithashtu mund të hipotizohet për një periudhë mesatare një zhvillim i bashkëpunimit tejkufitar nëpërmjet përfshirjes së strukturave të tjera, veçanërisht pritëse, si për shembull Biblioteka Publike e Korçës ose Biblioteka Publike e Vlorës.

5. Aspekte të angazhimit me punë dhe të barazisë gjinore.

5.1 Projekti parashikon mundësi angazhimi me punë?

Po

Jo

5.2	Përshkrimi i mundësive të angazhimit me punë
	Projekti parashikon në brendësi të tij mundësi angazhimi me punë. Nxitja e punësimit është një aspekt i rëndësishëm nëpërmjet të cilit B.E. synon të luftojë papunësinë afatgjatë, për të nxjerrë në pah punën e zezë dhe për të nisur një proces afatgjatë me

domosdoshmëri legalizimin.

Për t'ju përgjigjur edhe këtyre problematikave do të futen në tre strukturat shqiptare nga muaji i 13-të në atë të 36-të të kohëzgjatjes së projektit, për bashkëpunim të përkohshëm 18 të rinj shqiptarë (6 për secilën prej tyre).

Detyra e tyre do të jetë realizimi i buletinëve tematikë dygjuhësh si dhe funksionimi i "Info Point Europa", përveç aktiviteteve të tjera të projektit.

Theksojmë se bëhet fjalë për angazhim pune të përkohshëm.

Në të vërtetë, shpresojmë që me ndihmën e Autoriteteve dhe fondeve publike financiare shqiptare, por mbi të gjitha, me financime të mëtejshme të B.E. dhe me institucionalizimin e raporteve midis Bibliotekave Italo-Shqiptare, si dhe me know-how e përfitur nga të rinjtë në dy vitet e fundit të projektit, bashkëpunimi i përkohshëm që sot projekti ofron të transformohet në punësim të përhershëm, sipas ligjeve shqiptare në fuqi.

5.3 Përshkrimi i ndikimit në angazhimin me punë, përsa i përket përfshirjes së të rinjve dhe aplikimi i kritereve të barazisë gjinore.

Ndikimi në angazhimin me punë

Projekti parashikon bashkëpunimin e përkohshëm të 21 të rinjve shqiptarë, të cilët, ashtu si të moshuarit e gratë, gjejnë vështirësi të mëdha punësimi. Të rinjtë në veçanti, përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme për zhvillimin social e ekonomik dhe për bashkëpunimin midis dy vendeve. B.E., nga njëra anë, në përpunimin e strategjisë për punësim, u ka kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve për futjen e tyre në tregun e punës dhe për zhvillimin e sipërmarrjes së re.

Shprehemi gjithashtu se 3 persona, ku prej tyre një shqiptar, do të punësohen për gjithë kohëzgjatjen e projektit, me detyrë koordinimin e përgjithshëm dhe se 3 të rinj, ku prej tyre 1 shqiptar do të mundësojnë instalimin e zyrave Info Point në 6 muajt e fundit të vitit të parë.

Theksojmë, se nga 21 të rinjtë që do të bashkëpunojnë përkohësisht në Shqipëri, 6 prej tyre (dy për secilin nga strukturat e Tiranës, elbasanit dhe Shkodrës) do të përfshihen në mënyrë specifike në aktivitetet e Info Point Europa, ndërsa 10 (pesë për secilin nga strukturat e

Elbasanit dhe Shkodrës) do të impenjohen në redaktimin (8 prej tyre) dhe në përkthimin (2 prej tyre) të buletinëve tematikë.

Barazia gjinore

Angazhimi me punë që projekti parashikon, respekton principin e barazisë gjinore me qëllim shmangien e diskriminimit gjinor në terma të punësimit e të papunësimit, e gjithashtu për t'i dhënë një sinjal konkret popullsisë shqiptare.

Në fakt, nga 18 të rinjtë shqiptarë që do të angazhohen me punë, 8 prej tyre duhet të jenë femra.

Në bindje me atë çfarë shprehur nga B.E. me Direktivën nr.2000/78/CE të Këshillit të 27 Nëntorit 2000, që “stabilizon një kuadër të përgjithshëm për luftën kundër diskriminimit bazuar mbi besimin ose bindjet personale, moshës ose tendencave seksuale, përsa i përket punësimit e kushteve të punës” me qëllim barazinë në trajtim dhe për të luftuar rrezikun e rëndë të “përrjashtimit social”.

E përmendim në fund edhe “Kartën e të drejtave fundamentale të Bashkimit Europian” të shpallur me madhësi në Këshillin Europian në Nizza në dhjetor 2000, e cila i jep rëndësi principit të “jo diskriminimit (art.21)” e të (barazisë burrë-grua (art.23))”.

5.4 Treguesit sasiorë rreth impenjimit të personave

	Në fillim të aktiviteteve			Në fund të aktiviteteve		
	Itali	Shqipëri	Itali + Shqipëri	Itali	Shqipëri	Itali + Shqipëri
Angazhimi me punë ku:						
Të rinj (nga 22-32 vjec)						
Gra						
Punësimi i përkohshëm i krijuar ku: (*)				6	23	29
Të rinj (nga 22-32 vjec)				2	20	22
Gra				4	10	14
Punësimi i përkohshëm i krijuar nga projekti ku:						
Të rinj (nga 22-32 vjec)						
Gra						

(*) Bëhet fjalë për 3 persona për realizimin e impiantit Info Point Europa vetëm semestrin e dytë të vitit të parë; 3 persona për stafin e koordinimit për të katër vitet, 21 persona gjatë dy viteve pranë strukturave.

5.6 – Personeli i angazhuar me punë në projekt

Funksioni	Roli	Impenjimi i kërkuar	
		Njësia	Sasia e muajve
Ekspert (n. 1) [shqiptar]	Krijimi i Observatorit të praktikave pozitive	Muaj	28
Ekspert (n. 1)	Bashkëpunim me Observatorin e praktikave pozitive	Muaj	28
Ekspert (n. 1)	Arkivi digjital NPM	Muaj	40
Konsulent (n. 3)	Relator Workshop NPM	Muaj	108
Ekspert (n. 2)	Cikle diskutimesh rreth buletinëve të botuar	Muaj	24
Ekspert (n. 1) [shqiptar]	Mediacion gjuhësor (përkthime të ndryshme)	Muaj	48
Ekspert (n. 1)	Webmaster Siti Web i projektit	Muaj	48
Ekspert (n. 1)	Projektet ekzekutive	Muaj	48
Ekspert (n. 1)	Elaborazione prototipi comunicazionali	Muaj	36
Ekspert (n. 1)	Monitoraggio e rendicontazione	Muaj	48
Konsulent (n. 1)	Premio di Best Practice	Muaj	36
Konsulent (n. 1)	Ufficio InfoPoint Europa	Muaj	36
Ekspert (n. 1) [shqiptar]	Mediazione linguistica (traduz. Bollettini in albanese)	Muaj	28
Ekspert (n. 2)	Redazione Bollettini italiani	Muaj	56
Ekspert (n. 2)	Affiancamento Bollettini albanesi	Muaj	48
Ekspert (n. 3) [shqiptar]	Mediazione linguistica (traduz. Bollettini In italiano)	Muaj	72
Ekspert (n. 8) [shqiptar]	Redazione Bollettini albanesi	Muaj	192
Operator (n. 2) [shqiptar]	Front office InfoPoint Europa	Muaj	48
Operator (n. 4) [shqiptar]	Front office InfoPoint Europa	Muaj	96
Ekspert (n. 1) [shqiptar]	Redazione reports Osservatorio buone pratiche	Muaj	28
Ekspert (n. 5) [shqiptar]	Valorizzazione carte d'archivio	Muaj	120
Ekspert (n. 5) [n. 1 shqiptar]	Staff di coordinamento progetto	Muaj	240

5.7 - Parashikohet mbështetja e projektit, në përfundim të programit të financiar, me burime financiare dhe/ose njerëzore dhe/ose teknike?

Po Jo

5.7.1	Ashtu siç është përmendur në paragrafin 5.2, ambicja qëndron që përveç projektit, me ndihmën e fondeve publike shqiptare, por mbi të gjitha, me investime të mëtejshme të Bashkimit Europian e me institucionalizimin e raporteve midis Bibliotekave Italo-Shqiptare, si dhe me vënien në përdorim të know-how të përfituar, bashkëpunimi i përkohshëm që projekti mund të mundësojë të kthehet në punësim të përhershëm, sipas ligjeve shqiptare në fuqi. Partnerët do të vënë në dispozicion burimet njerëzore e teknike për të mbështetur iniciativën.
-------	---

7. Integrimi

7.1	Integrimi ndërmjet ndërhyrjeve të propozuara nga projekti
	<p>Aksionet e parashikuara nga projekti integrohen ndërmjet tyre.</p> <p><u>Zhvillimi i burimeve njerëzore</u> Projekti parashikon të bëjë të aftë 18 të rinjtë shqiptarë, që fillimisht do të merren me buletinët tematikë dygjuhësh dhe me kryerjen e aktiviteteve të informimit të front-office. Ndërkohë do të vlerësohen me çmim nga Drejtorët e Bibliotekave ata që do të jenë më novatorët, gjithashtu do të realizohet një ballafaqim ndërmjet strukturave pjesëmarrëse në projekt përsa i përket metodave të drejtimit dhe, në bazë të rezultateve, do të realizohen workshop shtesë italo-shqiptare. Do të zhvillohet një proces trajnimi e axhornimi profesional për kërkuesit, operatorët arkivues, mësuesit shqiptarë të shkollave të mesme në koordinim me vlerësimin e kartave të arkivit në lidhje me marrëdhëniet italo-shqiptare.</p> <p><u>Investimet</u> Projekti parashikon investime në burimet njerëzore, si për ato që veprojnë në Shqipëri për t'ju krijuar kushtet për përdorimin e teknikave dhe pajisjeve të duhura, ashtu dhe për të tjerët të angazhuar për koordinimin e projektit, si dhe për institucionalizimin e çmimeve.</p> <p><u>Shoqërim dhe mbështetje në organizimin e shërbimeve</u> Projekti parashikon realizimin e aktiviteteve për favorizimin e formimit të know-how të nevojshëm për zhvillimin e burimeve njerëzore të punësuar, e kjo nëpërmjet asistencës së ekspertëve që veprojnë edhe në Shqipëri për të lehtësuar realizimin e shërbimeve të parashikuara. Gjithashtu projekti parashikon zhvillimin e seminareve operative e periodike, gjatë të cilëve do të analizohet metodologjia e organizimit dhe e efektivizimit të shërbimeve.</p> <p><u>Aktivite të konsulencës</u> Projekti parashikon që subjektet partnerë, përveç aktiviteteve që u janë besuar, do të përbëjnë pjesën më të rëndësishme të ekspertizës së impenjuar për zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara nga projekti.</p>

8. Inovazione

8.1	Përdorimi i teknologjive të reja të informimit dhe të komunikimit.
